



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Strategjia për Auditimet e Teknologjisë së Informacionit

Prishtinë, 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



Strategjia për Auditimet e Teknologjisë së Informacionit

Prishtinë, 2025

Lista e Shkurtesave

EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
IA	Inteligjenca Artificiale
IDI	Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit
ISA	Institucionet Supreme të Auditimit
ISACA	Shoqata e Auditimit dhe Kontrollit të Sistemeve të Informacionit- Information Systems Audit and Control Association
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
TI	Teknologjia e Informacionit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit (e Republikës së Kosovës)

Përmbledje e përgjithshme



Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Misioni i Zyrës Kombëtare të Auditimit është të ofrojë Kuvendit të Kosovës, institucioneve të tjera dhe qytetarëve informacione të besueshme, objektive dhe të pavarura lidhur me gjendjen dhe menaxhimin e burimeve publike. Zyra Kombëtare e Auditimit synon të jetë një model për sektorin publik në mënyrën se si ushtron funksionin e saj.

Përmes kryerjes së auditimeve cilësore, synojmë të forcojmë llogaridhënien në administratën publike dhe të kontribuojmë në përdorimin sa më efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet tona promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë për të kërkuar përgjegjësi nga drejtuesit e organizatave të audituara.

Zyra Kombëtare e Auditimit është e themeluar mbi baza të qëndrueshme ligjore dhe institucionale, të ndërtuara në bashkëpunim me institucionet supreme të auditimit. Është anëtare e plotë e INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, si dhe vazhdimisht investon në ngritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunon ngushtë me akterë relevantë dhe partnerë ndërkombëtarë.

Me zhvillimin e teknologjisë së informacionit është rritur rëndësia dhe nevoja për auditimin e sistemeve të informacionit, për t'i siguruar qytetarët dhe Kuvendin e Kosovës se këto sisteme janë në funksion të ofrimit të shërbimeve më të mira dhe të sigurta ndaj qytetarëve. Auditimi i sistemeve të informacionit bëhet përmes auditimeve të veçanta të TI apo në kuadër të auditimeve financiare, pajtueshmërisë dhe të performancës. Kjo qasje përkrahet edhe nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Udhëzuesit përkatës.

Së fundmi është e përkushtuar në qasjen strategjike për auditimet e TI dhe përdorimin e teknologjisë moderne.

Në këtë funksion, Zyra Kombëtare e Auditimit ka marrë pjesë aktive në programin e IDI LOTA Strategji dhe ka hartuar Planin Strategjik tre (3) vjeçar me parashikim për dy vite tjera për auditimet e teknologjisë së informacionit të cilin po e prezantojmë.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	7
Qëllimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës	8
Vizioni, misioni dhe vlerat	8
Partnerët	9
Mjedisi i jashtëm i ZKA-së	10
Pasqyrë e Mjedisit të Jashtëm të ZKA-së	10
Ndikimet për Zyrën Kombëtare të Auditimit	13
Mjedisi i brendshëm i ZKA-së	14
Faktorët kufizues	14
Stafi dhe burimet	15
Planet e zhvillimit të kapaciteteve të auditimit	15
Monitorimi, vlerësimi, financimi	18
Përmbledhje dhe konkluzione	18
SWOT Analiza	19
Shtojcat	21
Shtojca A: Kapacitetet, pajisjet, auditimet dhe domenet	21
Shtojca B: Numri i sistemeve të informacionit të identifikuar në sektorin publik	24
Shtojca C: Lista e aseteve të të dhënave	27
Shtojca D: Mundësitë e përmirësimit	27
Shtojca E: Inventarizimi i kapaciteteve	28
Shtojca F: Inventari i zgjidhjeve teknologjike të ndërtuara brenda organizatave	28

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit kryen auditime financiare, të pajtueshmërisë dhe të performances. Në kuadër të auditimeve të performances kryejmë auditime të teknologjisë së informacionit-TI.

Në vitin 2018 është themeluar Departamenti për kryerjen e Auditimeve të TI-së. Ky departament mbështet edhe auditimet financiare, pajtueshmërisë dhe të performancës.

Auditimi i Sistemeve të Informacionit përkufizohet si ekzaminimi i kontrolleve që lidhen me sistemet e informacionit të drejtuara nga TI, për të pasur siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomisë, dhe efektivitetit e sigurisë së sistemeve të informacionit.

Rëndësia e Auditimeve të TI-së porritet gjithnjë e më shumë me përdorimin e teknologjive të reja si Inteligjenca Artificiale-IA, cloud computing (shërbime kompjuterike cloud) dhe analiza e të dhënave të mëdha (big data), etj.

Në këtë funksion është zhvilluar Plani Strategjik i Zyrës Kombëtare të Auditimit (apo LOTA Strategji) për periudhën tri (3) vjeçare 2025-2027 me parashikim të veprimeve për dy vite tjera. Ky plan trason rrugëtimin e ZKA-së në këtë sektorë. Plani është zhvilluar në kuadër të Programit LOTA të IDI-Iniciativa për Zhvillimin e INTOSAI. Secila fushë, qëllim, objektivi dhe aktivitet është analizuar dhe përzgjedhur me kujdes, duke pas parasysh mundësitë e zbatimit të tyre. Në vijim të planit janë paraqitur në detaje analizat dhe drejtimet.

- Objektivi i planit strategjik është analizimi detaj i fushës së teknologjisë së informacionet në organizatë dhe jashtë saj dhe orientimi e shfrytëzimi efikas dhe efektiv i resurseve me qëllim të arritjes së misionit të organizatës.
- Përdoruesit e planit strategjik përveç si udhërrëfyes i brendshëm, ky plan do të jetë në dispozicion edhe për palët e interesit dhe partnerët tanë.
- Metodologjia për hartimin e këtij plani ka qenë gjithëpërfshirëse dhe është bazuar në Udhëzimet e IDI për LOTA Strategji, kemi formuar grupet punuese brenda organizatës, hulumtimin e brendshëm, hulumtimin e jashtëm, pyetësorët, intervistat, vizitat në teren, mbledhja e dëshmimeve etj..

Qëllimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) synon avancimin e auditimeve të TI-së dhe nxitjen e përdorimit të teknologjisë nga sektori publik (qeveria) për të përmirësuar standardet e sigurisë efikasitetit dhe transparencës në sistemet e informacionit. Adaptimi i mjeteve të avancuara në auditim si Inteligjenca Artificiale dhe analiza e të dhënave të mëdha (BigData) rritë thellësinë dhe saktësinë e auditimeve, duke mundësuar identifikimin më të mirë të rreziqeve dhe ofrimin e rekomandimeve të vlefshme për sektorin publik.

Në këtë mënyrë, ZKA do të luajë një rol kyç në transformimin digjital të qeverisë, duke ndikuar pozitivisht në përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore.

Vizioni, misioni dhe vlerat

Vizioni

Një departament i qëndrueshëm i auditimit, profesional që i shton vlerë ZKA-së dhe siguron qëndrueshmërinë dhe përdorimin e duhur të sistemeve të informacionit në vend.

Misioni

Nëpërmjet auditimeve të teknologjisë së informacionit me cilësi të lartë, ne ofrojmë siguri për performancën e sistemeve, sigurinë e informacionit dhe përputhshmërinë me legjislacionin, me synim arritjen e objektivave në ofrimin e shërbimeve efikase dhe të sigurta për qytetarët.

Vlerat

Vlerat tona pasqyrojnë angazhimin, integritetin dhe paanshmërinë e stafit të auditimit të TI-së. Punën e bazojmë në fakte, duke siguruar rezultate të besueshme dhe të drejta. Synojmë të jemi efikas, inovativ, të adaptueshëm dhe bashkëpunues me palët e interesit.

Partnerët

Departamenti për Auditimet e TI-së ka zhvilluar bashkëpunim me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm:

Të brendshëm dhe mandatorë janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, entitetet e audituara, Rregullatorët dhe Agjencitë e Pavarura për fusha specifike si dhe Departamentet e Auditimit brenda ZKA. Po ashtu kemi bashkëpunim me Institute profesionale në fushën e TI-së dhe organizata të shoqërisë civile të kësaj fushe.

Të jashtëm:

- ISA-t e rajonit, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, Kroacia, Mali i Zi, Turqia.
- ISA-t Evropiane, Polonia, Portugalia, Suedia, Norvegjia, Estonia, Holanda etj..
- EUROSAI-ITWG, IDI, INTOSAI, ARABOSAI etj.

Jemi pjesëmarrës aktiv në grupet punuese të TI-së në EUROSAI dhe dy programe zhvillimore të IDI, në PESA dhe LOTA.

Një bashkëpunim i veçantë do të realizohet me **ekspert vendorë privat** të specializuar në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Kontributi i tyre pritet sidomos në përafrimin e nivelit të zhvillimit ndërmjet sektorit privat dhe publik dhe në maksimizimin e ndikimit të auditimeve në jetën e qytetarëve.

Në vazhdimësi jemi të hapur për bashkëpunime dhe pjesëmarrje në auditime paralele regjionale dhe më gjerë me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe njohjes me praktikat më të mira audituese.

Mjedisi i jashtëm i ZKA-së

Pasqyrë e Mjedisit të Jashtëm të ZKA-së

Në Kosovë janë afërsisht gjashtë institucione kryesore të angazhuara për zhvillimin fushës së Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe zbatimin e ligjit në këtë fushë: **Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në kuadër të kësaj ministrie, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë (ME), Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT më tej MF), Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)**. Ministria e Ekonomisë, ARKEP e deri në një masë MPB me aktivitetet e tyre mbulojnë sektorin publik dhe sektorin privat, institucionet tjera mbulojnë sektorin publik me aktivitetet e tyre.

Legjislacioni ekziston dhe mbulon çështje kyçe të TI-së, si mënyra e organizimit, përgjegjësitë, e-Qeverisja, identifikimi elektronik, dokumentet elektronike, siguria informacionit, investimet dhe vlefshmëria ligjore e komunikimit digjital në administratë.

Për shembull, legjislacioni i **ARKEP** kërkon transparencë dhe raportim për cilësinë e shërbimeve nga operatorët, duke përmirësuar konkurrencën, rritur sigurinë dhe zbatimin e standardeve.

ASHI-ja është institucion qendror që mbështet digjitalizimin e shërbimeve publike dhe qeverisjen elektronike, investimet në fushën e TI-së, menaxhon dhe ruan të dhënat shtetërore, ndërsa **Ministria e Ekonomisë** promovon sektorin e TI-së në nivel vendi, duke përfshirë tregtinë elektronike dhe teknologjitë e reja si Inteligjenca Artificiale, IoT (Interneti gjërave), BigData, etj.

Siguria kibernetike mbulohet nga **MPB** përmes legjislacionit dhe **Agjencisë për Siguri Kibernetike**, si dhe nga ekipet për reagim ndaj emergjencave kompjuterike KOS-CERT, ndërsa **Ministria e Financave** menaxhon me sistemet e informacionit të centralizuara për tërë sektorin publik të cilat janë kyçe për menaxhimin e financave publike.

Dokumentet dhe strategjitë kyçe në fushën e TI-së janë:

1. Agjenda Digjitale e Kosovës 2030, synon transformimin e Kosovës në një shoqëri digjitale, me objektiva si mbulimi kombëtar me 5G, lidhje gigabit për çdo familje dhe biznes, digjitalizim të plotë të shërbimeve publike dhe sigurimin e aftësive digjitale bazë për 95% të popullsisë deri në vitin 2030.

2. Strategjia për Qeverisjen Elektronike (2023-2027), përqendrohet në digjitalizimin e sektorit publik përmes koordinimit, aftësive digjitale, ndërveprueshmërisë dhe sigurisë kibernetike, duke synuar qeverisje të qëndrueshme dhe të përqendruar tek përdoruesi.

3. Strategjia për Teknologjinë e Informacionit, fokusuar në zhvillimin e industrisë së TI-së për ta bërë Kosovën një ekonomi të bazuar në dije dhe një motor për rritje ekonomike, inovacion dhe konkurrueshmëri ndërkombëtare.

4. Plani i Veprimit për Qeverisjen Elektronike (2023-2025), mbështet transparencën dhe përfshirjen qytetare, duke përfshirë krijimin e portalit e-Kosova, promovimin e të dhënave të hapura dhe përmirësimin e pjesëmarrjes qytetare në qeverisje.

5. Strategjia për Sigurinë Kibernetike, synon përforcimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike për të mbrojtur Kosovën nga kërcënimet kibernetike dhe për të ndërtuar bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë fushë.

Bazuar në legjislacionin vendor dhe dokumentet strategjike institucionet janë duke bërë përparime të dukshme në zhvillimin dhe zbatimin e politikave në fushën e TI-së dhe digjitalizimit.

Sfidat janë kryesisht për staf jo të mjaftueshëm e profesional, burokraci në prokurim, mungesë e koordinimit ndërinstitucional, monitorimit të duhur etj..

Sistemet e TI-së ne nivel vendi

Në skanimin tonë janë përfshirë rreth 130 organizata të ndryshme publike si: Ministri, Komuna, Agjenci, Universitete, Ndërmarrje Publike si dhe organizata tjera publike.

Këto organizata posedojnë rreth 430 aplikacione dhe sisteme të teknologjisë së informacionit. Shumica prej këtyre sistemeve apo rreth 310 janë në institucionet qendrore publike përfshirë agjencitë. Ndërsa rreth 120 sisteme tjera janë në komuna, ndërmarrje publike, Universitete dhe tjera. Shumica e këtyre sistemeve janë ndërtuar në bazë teknologjisë tradicionale. Varësisht nga madhësia dhe kompleksiteti, kryesisht janë ndërtuar me JAVA, ASP.NET, JavaScript, etj. Për databaza, përdoren platforma të ndryshme si ORACLE, SQL, MySQL, etj. Megjithatë shumë prej tyre edhe përkrahin teknologjinë moderne.

Tabela e sistemeve dhe organizatat:

Institucionet	Nr. i sistemeve
Ministritë	190
Ndërmarrjet Publike & SH.A	78
Komunat	37
Institucionet & Agjencionet e pavarura	124
Total	429

Në Institucionet qendrore përveç numrit më të madh të sistemeve ato posedojnë sistemet më të rëndësishme dhe më komplekse, sisteme të centralizuara dhe sisteme me rëndësi strategjike.

Analizat tona strategjike tregojnë se një sistem informacioni i centralizuar mbulon deri në 90 organizata buxhetore/publike. Ngjashëm është edhe me sistemet e informacionit strategjike. Mandej sistemet e informacionit në përdorim nga Ndërmarrjet Publike janë të njëjta apo të ngjashme. Sistemet e njëjta janë kryesisht të ndërmarrjet publike që mbulojnë sektorë të njëjtë, si për shembull në rreth 10 kompani të furnizimit me ujë. Po ashtu menaxhimi i sistemeve të informacionit është i ngjashëm në 38 komuna.

Ndërsa ASHJ-ja si agjenci qendrore aktualisht menaxhon me rreth 30 sisteme/aplikacione apo sisteme informacioni të institucioneve publike dhe është përgjegjëse për Qeverisjen elektronike në vend, aspektet e sigurisë si dhe ruajtjen dhe menaxhimin

e të dhënave dhe qendrës së të dhënave shtetërore. Po ashtu miraton dhe monitoron investimet në fushën e teknologjisë për të gjitha institucionet publike.

Vitet e fundit në Kosovë ka filluar të rritet numri i të rinjëve që orientohen në fushën e TI-së dhe në studimet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit-TIK. Qeveria e Kosovës ka prioritetuar reformat për një administratë publike moderne, efikase dhe të fokusuar të qytetari.

Andaj qasja jonë në selektimin e sistemeve për auditim do të ketë parasysh të gjithë këta faktorë. Ndër tjera do të merren parasysh Sistemet strategjike, qasja sipas rrezikut, sistemet e centralizuara, sistemet e ndërmarrjeve publike, organizatat specifike, organizatat e ngjashme, etj..

Ndikimet për Zyrën Kombëtare të Auditimit

Me rritjen e përdorimit të teknologjisë moderne shkaktohen edhe implikime si në shërbimet ndaj qytetarëve po ashtu edhe ndaj institucioneve mbikëqyrëse e audituese siç është Institucioni Suprem i Auditimit-ISA.

Në organizatat zbatuese/ekzekutive rreziqet ndërlidhen kryesisht me integritetin e sistemeve, privatësinë e të dhënave, sigurinë e informacionit në sistemet publike etj. Kjo po ashtu ndikon në nivelin e shërbimeve gjithëpërfshirëse, besueshmërinë, transparencën dhe në përgjithësi në mirëqenien e qytetarëve.

Ndërsa roli i ZKA-së rritet edhe më shumë për vlerësimin dhe ofrimin e sigurisë së sistemeve janë të sigurta, të besueshme dhe ofrojnë shërbime efikase.

Në këtë funksion ZKA duhet të jetë në hap me kohën, e mirëinformuar me zhvillimet dhe e gatshme për këtë lloji të auditimeve. Të përgatisë staf dhe të zbatojë mjete dhe teknologji adekuate në auditimin e sistemeve moderne të automatizuara dhe të dhënave komplekse.

Andaj qasja e ZKA-së në auditimin e sistemeve duhet të jetë strategjike e planifikuar dhe bazuar në rrezik me qëllim të ndikimit sa më të lartë dhe dhënien e rekomandimeve përmirësuese e në kohë.

Auditimet në kohë reale, koordinimi i institucioneve, ndërveprueshmëria e sistemeve dhe çështjet e sigurisë së informacionit/sistemeve janë ndër fushat ku ZKA duhet të fokusohet.

Përmes auditimeve cilësore efikase/efektive ZKA duhet të rekomandoj dhe ndihmoj organizatat publike në përdorimin sa më efikas dhe efektiv të teknologjisë së informacionit veçanërisht atë moderne.

Mjedisi i brendshëm i ZKA-së

Faktorët kufizues

Zyra Kombëtare e Auditimit-ZKA është institucion i pavarur auditues sipas Kushtetutës, ka ligjin e vet që i siguron pavarësi financiare dhe operacionale. Po ashtu ka strategjinë 3 vjeçare të organizatës. Ka të punësuar mbi 160 staf me plan rritje mbi 190 në tri vitet e ardhshme. Staf auditues janë rreth 130, pjesa më e madhe e tyre auditor financiar ndërsa rreth 20 auditor të performances dhe TI-së.

ZKA ka një strukturë të organizuar në departamente për auditime financiare, pajtueshmëri dhe performancë si dhe pjesa administrative. Në kuadër të Divizionit të performancës përfshihen auditimet e Teknologjisë së Informacionit.

Metodologjia e përdorur për auditimet e TI-së bazohet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit si, SNISA 3000, GUID 5100, Manualin e IDI të adaptuar në gjuhën shqipe për auditimet e TI-së, veglat e punës online të Grupit Punues të TI-së (ITWG) EUROSAI, si dhe pakon e letrave të punës për auditimet e performancës në ZKA. Po ashtu përcjellën zhvillimet e fundit metodologjike.

Departamenti ka bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e EUROSAI në grupin për TI, në veçanti në nëngrupin për e-Qeverisje. Po ashtu, ekziston një partneritet i qëndrueshëm me Institucionet Supreme të Auditimit (ISA) evropiane dhe të rajonit, në veçanti me ISA-n e Shqipërisë, Polonisë, Portugalisë, Suedisë dhe Norvegjisë.

Stafi dhe burimet

Departamenti për auditimet e TI-së përbëhet nga katër auditorë të TI-së, ku tre prej tyre janë auditorë senior të profilizuar në fushën e TI-së, njëri me përvojë të lartë dhe ekspert në këtë fushë si dhe drejtori i departamentit. Andaj si ekip posedojnë kompetencë profesionale krahas kompleksitetit të auditimeve dhe sistemeve që janë në përdorim nga sektori publik.

Janë në gjendje të mbulojnë domenet e auditimit të TI-së sipas kërkesave të standardeve dhe manualit të IDI si dhe mund të përdorin mjetet audituese për TI si dhe të bëjnë analizimin e thellë të të dhënave.

Ndërsa fushat ku kanë nevojë për zhvillim dhe aftësim janë: pjesa e sigurisë kibernetike, testet e penetrimit, të dhënat e mëdha-BigData, inteligjenca artificiale, auditimi algoritmeve etj.

Qëllimi është siguri i kapaciteteve profesionale të mjaftueshme me mbulimin e pozitave audituese të parashikuara deri 3 ekiye/6 auditor. Stafi i trajnuar për auditim të TI-së dhe përdorimin e mjeteve të avancuara teknologjike.

Planet e zhvillimit të kapaciteteve të auditimit

Zhvillimi i kapaciteteve audituese dhe të përdorimit të teknologjisë duhet të bëhet në disa drejtime në mënyrë që ZKA si organizatë të jetë e gatshme për arritjen e misionit të saj në mënyrë efektive.

Zhvillimi duhet të filloj nga auditorët e TI-së, ndikimi i të cilëve do të shtrihet në tërë organizatën dhe entitetet e audituara duke kryer auditime të TI-së moderne si sisteme komplekse, IA dhe auditime të dhënave të mëdha si dhe duke përdorur teknologjinë/veçat e avancuar gjatë auditimeve.

Auditorët e TI-së do të mbështesin dhe trajnojnë auditorët financiar në punën e tyre për pjesën e TI-së. Të përzgjidhen auditor financiar të motivuar e të talentuar në fushën e TI-së të trajnohen për përdorimin e teknologjisë dhe auditimin e të dhënave në sisteme të TI-së.

Departamenti për shërbimet e TI-së në ZKA duhet të siguroj pajisje të TI-së të mjaftueshme dhe të avancuara për auditim dhe ruajtjen e sigurt të të dhënave audituese.

Kapacitetet dhe Burimet - Kapacitetet departamentale që mundësojnë menaxhim dhe auditime të TI-së efektive.

Sigurimi i kapaciteteve profesionale të mjaftueshme	Krijimi i parakushteve rregullative dhe financiare për rekrutim të stafit profesional (6) Mbulimi i pozitave audituese të parashikuara Stafi i trajnuar për auditim dhe përdorimin e të teknologjisë moderne dhe mjeteve të avancuara teknologjike Auditorët e TI të trajnuar dhe certifikuar (mbi 80%) Auditor financiar të trajnuar për auditim bazik të sistemeve 15 staf/3 vite
Zhvillimi i infrastrukturës së avancuar teknologjike për auditimet e TI-së	Infrastrukturë e sigurt dhe e avancuar për mbështetje të auditimeve-3 vite Trajnime profesionale për përdorimin e mjeteve të avancuara dhe auditimin e tyre Pajisja e auditorëve me mjete dhe sisteme të avancuara (100%/3vite) Kapacitetet dhe mundësia për auditimin e teknologjisë së avancuar
Përmirësimi i metodologjive të auditimit të TI-së	Adaptimi i metodologjisë, udhëzuesve dhe standardeve të fundit ndërkombëtare për auditimet e TI që rrisin efikasitetin dhe cilësinë e auditimeve Njohuri të mira të tyre dhe aplikim i plotë në proceset audituese (100%)
Menaxhimi i rreziqeve	Kapacitete të mjaftueshme dhe metodologji për menaxhimin e rreziqeve Rreziqet në fushën e TI-së identifikohen, vlerësohen dhe menaxhohen në mënyrë efektive (95%)

Rritja e numrit të auditimeve të TI-së	Rritja e vazhdueshme numrit të auditimeve të TI-së me qëllim rritjen e ndikimit të auditimeve në sistemet e informacionit Mbulimi i sa me shumë entiteteve me rëndësi dhe sistemeve të informacionit me rrezik të lartë Rritja e ndikimit dhe siguri më e lartë për sistemet e informacionit dhe sigurinë e tyre
Trajtime profesionale të avancuara	Trajtime profesionale për sisteme dhe mjete të avancuara në auditim për mbulimin e gjitha domeneve/kërkesave për auditim. Se paku dy sesione trajnime vjetore tërë stafi ATI Projekte bashkëpunimi në baza vjetore me SAI-t e zhvilluara Punëtori për Auditime të TI&pjesëmarrje në punëtori të ndryshme

Në vazhdimësi do të zgjerohet fushëveprimi i auditimeve të TI-së. Do të rritet numri i sistemeve të audituara, institucioneve dhe llojet e domeneve që do të mbulohen. Për tri vite do të auditohen rreth 24 sisteme të informacionit dhe për 5 vite rreth 48 sisteme. Plani dhe caqet në detaje janë paraqitur në shtojcën e këtij dokumenti.

Domenet që do të mbulohen në tri vitet e para janë kryesisht: Qeverisja TI, kontraktimi, Plani vazhdimësisë biznesit-PVB dhe Plani për rimëkëmbje nga fatkeqësitë-PRF, Operacionet e TI, Siguria informacionit dhe kontrollet e aplikacionit. Në vitin/sezonën 2026/2027 do të kryhet auditim mbi teknologjinë moderne nëse aplikohet dhe do të përgatitet infrastruktura dhe stafi për inteligjencën artificiale si dhe PEN test.

Kapacitetet audituese do të zhvillohen krahas zhvillimeve teknologjike dhe rritjes së numrit të auditimeve. Në vitin e parë dhe dytë do të kemi 4 auditorë të trajnuar në Sigurinë e informacionit dhe kibernetike, po ashtu do të fillojnë trajnimet në këto fusha dhe të pajisen me kompjuter modern dhe vegla pune të mjaftueshme. Do të kryhen 3 auditime të TI-së, përfshirë 8 sisteme të TI-së dhe rreth 7 entitete publike. Po ashtu do të kryhet një auditim pilot me auditorët financiar. Pra rezultati do të jetë më i lartë dhe i vlefshëm se sa investimet. Mandej me kalimin e viteve investimet do të zvogëlohen dhe numri i auditimeve do të rritet, pra ndikimi ynë do të jetë më i lartë për ZKA dhe sektorin publik. Investimi 3 vjeçar parashihet rreth 40,000 euro ndërsa Rezultati do të jetë Departament i qëndrueshëm dhe i aftë të përdorë teknologjinë moderne dhe të kryej auditime të teknologjisë moderne. Po ashtu do të mbahen punëtori me partnerët

për rezultatet dhe zhvillimet e mëtejshme në auditimet e TI. Në shtojcë është paraqitur në mënyrë detaje trajnimet, pajisjet dhe kostot për arritjen e këtyre caqeve.

Auditimet do të kryhen sipas qasjes së kombinuar të bazuar në rrezik, të bazuar në të dhënat në shtojcën A dhe B. Që të jemi efikas dhe efektiv, entitetet dhe sistemet kryesore do të analizohen dhe selektohen çdo vit me planin vjetor.

Monitorimi, vlerësimi, financimi

Strategjia për auditimet e TI dhe përdorimin e teknologjisë do të zbatohet nga Departamenti për Auditimet e Teknologjisë së Informacionit. Monitorimi primar do të jetë nga Drejtori i këtij Departamenti në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve të TI-së në ZKA. Për arritjen e Objektivit të kësaj strategjie është hartuar plani veprimi i cili do të zbërthehet në planet vjetore të auditimit në kuadër të Departamentit për Auditimet e TI-së. Vlerësimi i zbatimit të saj bëhet në baza vjetore. Progresi dhe mësimet e mësuara i raportohen Auditorit të Përgjithshëm.

Strategjia ka nevojë për financim adekuat. Zhvillimi i stafit dhe sigurimi/adaptimi i teknologjisë moderne kanë nevojë për financim shtesë. Kjo do të arrihet përmes planifikimit adekuat buxhetor dhe donatorëve. Donatorët sidomos janë të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore si trajnime etj. Planifikohet se paku rreth 20% e kostove buxhetore të mbulohet nga donatorët si në rastin programeve trajnuese etj.

Përmbledhje dhe konkluzione

Përdorimi teknologjisë moderne është në fazat e para të zbatimit si nga Zyra Kombëtare e Auditimit ashtu edhe nga institucionet publike në vend. Megjithatë planet strategjike tregojnë se përdorimi i teknologjisë moderne dhe inteligjencës artificiale tashmë po bëhet realitet. Zyra Kombëtare e Auditimit ka vizion të qartë rreth përdorimit të teknologjisë moderne dhe auditimeve të tyre.

Janë tri drejtime kryesore për arritjen e vizionit: resurset e mjaftueshme profesionale, mjetet dhe metodologjia adekuate e punës si dhe bashkëpunimi me palët e interesit e në veçanti me ISA-t evropiane. Për këtë arsye duhet buxhetim i drejt financiar, njerëzor dhe operativ.

Qasja e planifikuar në auditimet e TI-së do të siguroj maksimizimin e përfitimit nga palët e interesit dhe vetë ZKA-së. Auditimet e TI-së me fokus të kombinuar dhe përdorimi i mjeteve modrene në auditim, janë mënyrë e mirë, si:

- kombinimi i sistemeve të rëndësishme e strategjike,
- institucionet kyçe në vend për fushën e TI dhe sigurinë e informacionit,
- sistemet e centralizuara që mbulojnë shumë organizata,
- organizata përdorin sisteme të njëjta,
- fokusi në domenet kyçe në auditimet e veçanta dhe horizontal etj.

Kjo qasje ndikon që ISA të jetë më efektive dhe efikase në punën e saj si dhe në ofrimin e sigurisë për këto sisteme.

Strategjia për auditimet e TI-së dhe përdorimit të teknologjisë moderne është udhërrëfyes i mirë drejt arritjes së këtyre qëllimeve.

SWOT Analiza

Strengths	Weaknesses
Kornizë ligjore dhe institucionale e fortë	Burime financiare dhe njerëzore të kufizuara
Departament i qëndrueshëm për auditime të TI-së me staf të kualifikuar	Sfidë/mungesë në aftësitë për sigurinë kibernetike dhe testimet e penetrimit
Qasje e planifikuar dhe mundësi e përdorimit të mjeteve të avancuara si SITA dhe IDEA	Infrastrukturë e pamjaftueshme jo moderne për auditime e TI komplekse dhe dhënave të mëdha
Vizion strategjik për përdorimin e teknologjisë moderne, AI dhe të dhënave të mëdha	Nevojë për trajnime më të avancuara për stafin e auditimit
Bashkëpunime ndërkombëtare me ISA evropiane, rajonale dhe ekspertë	

Opportunities	Threats
Integrimi i teknologjive të reja moderne si AI dhe cloud computing	Rreziqet kibernetike dhe sulmet ndaj sistemeve publike
Digjitalizimi i sektorit publik rrit rëndësinë e auditimeve të TI-së	Shpejtësia e zhvillimeve teknologjike mund të tejkalojë kapacitetet
Mundësia për lidërsip rajonal në auditimet e TI-së	Mungesa e mbështetjes dhe koordinimit ndërinstitucional
Mbështetja nga donatorët për zhvillimin e kapaciteteve	Konkurrenca për burime, rreziqet në sigurimin e burimeve të mjaftueshme humane/profesionale
Pjesëmarrja në programe strategjike ndërkombëtare (si IDI LOTA)	

Shtojcat

Shtojca A: Kapacitetet, pajisjet, auditimet dhe domenet

Përshkrimi/viti	I-2025	II-2026	III-2027	IV-2028	V-2029
Stafi	4	6	7	7	7
Auditimet TI	3	3	4	4	5
Mbështetje/ ekipe	2	2	3	3	3
Sisteme/ aplikacione	8	6	8+7		
Entitete në auditim	7	8	9+7	11	11
Lloji entitetit	Qendrore	Qendrore, NP	Qendrore, Lokale	Qendrore, NP, Lokale	Qendrore, NP, Lokale
Domenet/testet	Qeverisja TI-së, kontraktimi	Qeverisja TI-së, kontraktimi	Qeverisja TI-së, kontraktimi	7 Domenet dhe AI	7 Domenet dhe AI
	Siguria informacionit kontrollet e aplikacionit	Plani vazhdimësisë biznesit PVB+PRF	Plani vazhdimësisë biznesit PVB+PRF&domenet tjera		
	Operacionet e TI-së				
	Siguria informacionit kontrollet e aplikacionit				
	Operacionet e TI-së				
	Siguria informacionit kontrollet e aplikacionit				

Domenet tjera sipas temës		IA-Inteligjenca Artificiale dhe PEN TEST			
Caqet	3 Auditime të TI-së	3 Auditime të TI-së	4 Auditime të TI-së	4	5
Caqet	1 Auditim TI-Financiar	2 Auditime TI-Financiare/ Pajtueshmeri/ Performance	3 Auditime TI-Financiare/ Pajtueshmeri/ Performance	3	3

Zhvillimi kapaciteteve	I-2025	II-2026	III-2027	IV-2028	V-2029
Trajnimet	1. Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS) bazuar në ISO/IEC 27001 2.Siguria Kibernetike (ISA Norvegjisë dhe Suedisë) 3. IDI - ISACA Trajnime (CISA, CRISC, CISM)	1. IDI - ISACA Trajnime (CISA, CRISC, CISM)	1. Zhvillimet e reja teknologjike, teste depërtimi (penetration test)	1. Zhvillimet e reja teknologjike	1. Zhvillimet e reja teknologjike
		2. IA- Inteligjenca Artificiale	2. Trajnime me ISA Evropiane	2. Trajnime me ISA Evropiane	2. Trajnime me ISA Evropiane
		3. IDI - ISACA Trajnime (CISA, CRISC, CISM)	3. Siguria Kibernetike, analiza të thella, teste depërtimi, të dhëna të mëdha	3. Trajnime tjera në fushën e TI/auditimit	3. Trajnime tjera
		4. Trajnime tjera në fushën e TI/auditimit			

Caqet	4 auditor të trajnuar	5 auditor të trajnuar/ certifikuar	6 auditor të trajnuar/ certifikuar	7 auditor të trajnuar	7 auditor të trajnuar
Kosto	4,500	4,500	4,500		
Ekspertet	Një ekspert vendor	Një ekspert vendor	Bashkëpunime sipas nevojës-ekspert vendor	Bashkëpunime sipas nevojës sipas nevojës	Bashkëpunime sipas nevojës sipas nevojës
Punëtori	Bashkëpunime sipas nevojës-ekspertë ndërkombëtar	Bashkëpunime sipas nevojës-ekspertë ndërkombëtar	Bashkëpunime sipas nevojës-ekspertë ndërkombëtar	Bashkëpunime sipas nevojës sipas nevojës	Bashkëpunime sipas nevojës sipas nevojës
	Punëtori për auditimet e TI		Punëtori për auditimet e TI		
Kosto	2,000	3,000	3,500		
Pajisjet	Pajisje/Llap top modern me fuqi të mjaftueshme	Pajisje/Llap top modern me fuqi të mjaftueshme	Pajisje/Llap top modern me fuqi të mjaftueshme	Pajisje moderne	Pajisje moderne
	Softuer, vegla, aplikacione	Softuer, vegla, aplikacione	Softuer, vegla, aplikacione		
Caqet	2 auditor të pajisur	4 auditor të pajisur	5 auditor të pajisur	6 auditor të pajisur	6 auditor të pajisur
Kosto	6,500	6,500	4,500		
Kosto total	13,000	14,000	12,500	-	-

Shtojca B: Numri i sistemeve të informacionit të identifikuara në sektorin publik¹

Emri i institucionit	Nr sistemeve	Emri i institucionit	Nr sistemeve
N.P.L STACIONI AUTOBUSEVE SH.A FERIZAJ	1	Kompania Ujësjiellësi Rajonal Sh.A. "BIFURKACIONI"	2
Kompania Ujësjiellësi Rajonal Sh.A. "HIDROREGJIONI JUGOR"	4	Kompania Ujësjiellësi Rajonal Sh.A. "GJAKOVA"	2
Kompania Ujësjiellësi Rajonal Sh.A. "MITROVICË"	5	Kompania Ujësjiellësi Rajonal Sh.A. "HIDRODRINI"	2
Kompania Ujësjiellësi Rajonal Sh.A. "PRISHTINA"	6	Kompania Ujësjiellësi Rajonal Sh.A. "HIDROMORAVA"	4
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	4	Komuna Dragash	1
Administrata Tatimore e Kosovës	6	Komuna Fushë-Kosovë	1
Agjencia e Kosovës për Akreditim	2	Komuna Gjakove	6
Agjencia e Kosovës për efqiencë të energjisë	2	Komuna Malishevë	1
Agjencia e Kosovës për Forenzikë	4	Komuna Prizren	1
Agjencia e Kosovës për Krahassim dhe Verifikim të Pronës	1	Komuna Rahovec	2
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale	1	Komuna Skenderaj	2
Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave	3	Komuna Shtime	1
Agjencia e Statistikave të Kosovës	8	Komuna Vushtrri	2

¹ Lista e prioritarizuar sipas rrezikut për auditime vendoset në planin vjetor të auditimit dhe rishikohet e plotësohet sipas rreziqeve dhe nevojës.

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	6	Korporata Energjetike e Kosovës	5
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	7	KOSTT sh.a.	9
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	3	KRM "Çabrati" SHA	2
Agjencia Kadastrale e Kosovës	10	KRM "Pastërtia" SH.A. Ferizaj	1
Agjencia Kosovare e Privatizimit	4	KRU Radoniqi-Dukagjini SHA Gjakovë	2
Agjencia Kosovare për Standartizim / MINT	1	Kuvendi i Republikës së Kosovës	2
Agjencia Kosovës për Akreditim	2	MMPHI/Departamenti Planifikimit Hapsinor-DHPNB	3
Agjencia kundër Korrupsionit	2	Ministria Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit	9
Agjencia për Informim dhe Privatësi		Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL	4
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e NMV	1	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	8
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit e Kosovës	4	Ministria e Drejtësisë	7
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	1	Ministria e Ekonomisë	1
Agjencia për Pronësi Industriale - MINT	1	Ministria e Ekonomisë	7
Agjencia për Regjistrim të Bizneseve	2	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	26
Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë	7	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	3
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	1	Ministria e Infrastruktures	1
Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Sekestruar dhe të Konfiskuar	1	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	3
Akademia e Drejtësisë	6	Ministria e Punëve të Brendshme	16

Akademia e Kosovës për Siguri Publike	9	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	2
Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës	6	Ministria e Shëndetësisë	6
ARRU	1	Ministria e Zhvillimit Rajonal - MZHR	1
Autoriteti i Aviacionit Civil	2	Ministria për Komunitete dhe Kthim	1
Autoriteti Rajonal i Pëllgjeve Lumore / MMPHI	1	Mitrovica e Jugut	2
Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	5	Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.	1
Dogana e Kosovës	8	Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" SH.A	4
Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)	3	NPL-Stacioni i Autobusëve-Ferizaj	1
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	4	Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës	1
Gjykata Kushtetuese e R. Kosovës	2	Organi Shqyrtues i prokurimit	1
Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A	8	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP	1
Infrakos	3	Policia e Kosovës	4
Inspektorati Policor i Kosovës	2	Posta e Kosovës Sh.A.	1
Institucioni i Avokatit të Popullit	3	Qendra Klinike dhe Universitare e Kosoves	6
Institucioni i mjekësis ligjore	2	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	2
Instituti Hidro Meteorologjik i Kosovës	6	Stacioni i Autobuseve SH.A, Prishtine	2
Instituti i Planifikimit Hapësinor	1	Sherbimi Korrektues i Kosovës	1
Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)	2	Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, Departamenti i Sizmologjisë	1
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	5	Shërbimi Korrektues i Kosovës	3

Këshilli i pavarur mbikqyrës për shërbimin civil të Kosovës	1	Shërbimi Sprovues i Kosovës	1
Këshilli Prokurorial i Kosovës	8	Telekomi I Kosovës	7
KK Drenas	1	Termokos	1
KK Hani_Elezit	17	Trepça SH.A.	1
KMDK SH.A	6	Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë	1
Komisioni i Pavarur i Mediave	2	Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë	1
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	2	Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë	7
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	8	Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	1
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	1	Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren	1
Zyra Kombetare e Auditimit	1	Universiteti Ferizaj	2
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	3		
	229		200
Numri total i sistemeve	429		

Shtojca C: Lista e aseteve të të dhënave

Lista e mjeteve dhe pajisjeve të cilat janë të nevojshme dhe ndihmojnë audituesit në ekzekutimin e auditimeve janë: pajisjet kompjuterike, softuer të auditimit si IDEA, mjetet për auditime moderne, qasja në platforma online për planifikimin e auditimeve dhe vlerësime të rreziqeve, pajisje dhe njohuri për auditime të IA dhe mjete inteligjente. Po ashtu metodologji adekuate qasje të mjaftueshme në trajnime dhe resurse të mjaftueshme humane e financiare.

Shtojca D: Mundësitë e përmirësimit

Përmirësimi teknologjik mund të kontribuojë në një auditim më të fortë dhe më efektiv nga SAI. Mundësitë për automatizimin e proceseve dhe përdorimin e mjeteve të inteligjencës artificiale për analizë të avancuar të të dhënave do të ndihmonin në auditime efektive dhe të sakta dhe të besueshme.

Shtojca E: Inventarizimi i kapaciteteve

Përcaktimi i qartë i kapaciteteve teknologjike Brenda SAI, duke përfshirë aftësitë e stafit, nivelet e përgatitjes, përdorimin e teknologjisë, certifikimet dhe trajnimet e marra. Kjo ndihmon për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve njerëzore dhe nevojat për zhvillim të mëtejshëm në fushën e teknologjisë. Po ashtu kjo ndihmon edhe përcaktimin e fokusimit të auditimeve në fushën e TI-së.

Shtojca F: Inventari i zgjidhjeve teknologjike të ndërtuara brenda organizatave

Softuerët – vegla – aplikacione të mundshme:

Sistemet Operative: Windows 10, Windows Server 2022, Linux, Kali Linux

Ambiente për administrimin dhe analizën e bazave të të dhënave: SQL Server 2022

Vegla tjera për hapësirë punuese: VMware Workstation Pro

Vegla për skanim dhe testim të dobësive: Nessus: Për skanim të dobësive në sisteme dhe aplikacione.

Acunetix: Auditon aplikacionet tuaja ueb duke kontrolluar për dobësi si SQL Injection, Cross-site scripting, dhe dobësi të tjera të shfrytëzueshme.

Vegla për monitorim të rrjetit dhe analiza: Wireshark: Për kapje dhe analizë të trafikut të rrjetit. Splunk: Për analiza të të dhënave dhe log-ëve. Zeek (Bro): Vegël për analizë të sjelljeve të rrjetit.

Vegla për testime penetrimi (Penetration Testing): Metasploit: Platformë për zhvillimin e testimeve të penetrimit. – Kali Linux Nmap: Skanues portesh dhe rrjetesh. – Kali Linux Hydra: Vegël për testimin e fjalëkalimeve. – Kali Linux. OWASP ZAP (Zed Attack Proxy): Vegël për testime të aplikacioneve web. – Kali Linux

Kriptografi dhe kontrollimi i integritetit: VeraCrypt: Për enkriptimin e të dhënave. Hashcat: Për testimin e fjalëkalimeve dhe çelësve. OpenSSL: Për kontrollim të certifikatave SSL dhe enkriptimin. Vegla të tjera...: përfshirë Bash Scripting: Për analizë dhe skriptim në sistemet Linux/Unix. Docker: Për testime në mjedise të izoluar.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës